



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

25.04.2013

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Reagim ndaj shkrimit me titull: (Pa) Siguria e investimeve në Kosovë

Prishtinë - Agjencia Kosovare e Privatizimit reagon ndaj shkrimit të publikuar dje në gazetën “Zëri” me titull: “(Pa) Siguria e investimeve në Kosovë”, duke vlerësuar si shmangie nga gjendja faktike e vërtetuar edhe me vendimin e gjykatës kompetente.

Agjencia sqaron për opinionin publik se për çështjen e trajtuar në shkrim është lëshuar me datë 20 mars 2013 aktgjykim nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës me numër të lëndës C-I.-12-0042, e cila gjykatë e ka refuzuar padinë e paditësit, ish blerësit të Ndërmarrjes së Re “Hoteli Grand”, si të pabazuar në Ligj, duke e vlerësuar të drejtë dhe në përputhje me Ligjin vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të datës 31 maj 2012 për tërheqje të aksioneve si pasojë e mosplotësimit të kushteve të kontratës.

Derisa pritet të lëshohet vendimi përfundimtar i Panelit të Ankesave pran kësaj Gjykate, AKP konsideron se është tejet e rëndësishme që palët e involvuara në këtë procedurë gjyqësore të kenë kujdes të veçantë që të mos ndërhyjnë përmes shkrimeve të ngjashme. Prandaj reagimi i Agjencisë vjen si nevojë për të qartësuar këtë pozicion për publikun, duke konsideruar se autori i shkrimit shkruan dhe shpreh opinionin në emër të kompanisë juridike “Interlex Associates LLC”, e cila e përfaqëson palën e kundërt në këtë proces gjyqësor.

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rr. Ilir Konushevci No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

FUND

Rr. Ilir Konushevci No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org